



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

STATUTI

I

**QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE “DR. NAGIP REXHEPI”
GJILAN**

Në mbështetje të Nenit 8 paragrafi 2, nenit 18 paragrafi 12 dhe nenit 45 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi (Gazeta Zyrtare nr 13, 07.05.2013), si dhe nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 38 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit nr. 01.nr.16-126211 të datës 06.11.2014, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.10.2015 miraton:

S T A T U T I N
E
QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE “DR. NAGIP REXHEPI”
GJILAN

Neni 1

I - Dispozitat e përgjithshme

Me këtë Statut rregullohen dispozitat e përgjithshme, emërtimi dhe selia, veprimtaria e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm profesional, mbikëqyrja e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, aktet e përgjithshme të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, pronësia dhe financimi, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së kujdesit shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Nagip Rexhepi” (në tekstin e mëtejme: QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”).

Neni 2

Statusi i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”

1. QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” ka statusin e personit juridik publik, me cilësi të autoritetit punëdhënës, ku organizohet, ofrohet dhe zbatohet Kujdesi Parësor Shëndetësor Publik (në tekstin e mëtejme: KPSH).
2. Themelues i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” është Kuvendi Komunal Gjilan.
3. QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”-ja në Gjilan ka filluar punën me 19__, fillimisht si “Shtëpi e Shëndetit”.

II - Emërtimi dhe selia

Neni 3

Emërtimi

1. Emri i institucionit është: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Nagip Rexhepi” në Gjilan.
2. Shenja njohëse e këtij institucioni është unike për të gjitha QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” në Republikën e Kosovës dhe aprovohet nga Kuvendi i Komunës, në bazë të procedurave ligjore.
3. Emërtimi i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, QMF dhe AMF duhet të jetë i mbishkruar qartë në hyrje të objektit në të cilin kryhet veprimtaria shëndetësore dhe edukative, në gjuhët zyrtare në Kosovë.
4. Për ndryshimin e selisë së QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” vendos themeluesi, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 4 Selia

Selia e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” në Gjilan gjendet në rrugën “Avdulla Tahiri” Nr. në Gjilan.

Neni 5 Vula

1. QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” posedon vulën e saj që në qarkullimin juridik paraqitet si Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Nagip Rexhepi”.
2. Vula është në formë të rrumbullakët dhe ka dimension 3.5 cm (35 mm).
 - 2.1. Rrethi i parë: Republika e Kosovës;
 - 2.2. Rrethi i dytë: Komuna e Gjilanit;
 - 2.3. Rrethi i tretë: QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” në Gjilan;
 - 2.4. Në mes të vulës është logoja unike për të gjitha QKMF në Republikën e Kosovës.
3. QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” posedon vulën katrore, me dimensione 5.5 cm x 3 cm. që përmban emërtimin, selinë dhe hapësirën për evidentimin e numrit dhe të datës së pranimit të dokumentit.
4. Vula duhet të përmbajë emërtimin e institucionit, sipas këtij Statuti dhe të jetë në gjuhët, të cilat janë në përdorim zyrtar në Kosovë.
5. Për numrin e vulave dhe vulat tjera të nevojshme për shërbimet brenda QKMF-se, mënyrën e përdorimit dhe për autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtje, vendos drejtori me vendim të veçantë.
6. Çdo vulë ka numër identifikues.

III – Veprimtaria, shërbimet dhe përfaqësimi i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”

Neni 6 Veprimtaria

1. Veprimtaria e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” përfshinë ofrimin e shërbimeve parësore shëndetësore për popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës.
2. Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve të Komunës së Gjilanit t’u ofrojë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse dhe efikase, të bazuar në të dhëna shkencore, përmes caktimit të mjekut familjar, i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuesit e shërbimeve në sistemin shëndetësor, dhe njëherit është pikë referuese për specialistët, konsulentët në nivelet tjera të kujdesit shëndetësor.
3. Sipas strategjisë të KPSH dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, ekipi i mjekësisë familjare i përbërë nga një mjekë familjar dhe dy infermiere familjare, ofron

shërbime shëndetësore për 2000/2500 banorë sipas shtrirjes territoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF.

4. Standardet në mjekësinë familjare sipas këtij statuti, do t'i nënshtrohen revidimit periodik nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë

5. Shërbimet shëndetësore në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” Gjilan, sigurohen dhe zbatohen nga profesionistët shëndetësor të cilët i plotësojnë kriteret e parapara në Ligjin për Shëndetësi:

5.1. Specialist në Mjekësia Familjare;

5.2. Doktor i Mjekësisë;

5.3 Doktor i Stomatologjisë;

5.4. Farmacist i diplomuar – magjistër i farmacisë;

5.5. Teknik laborant;

5.6. Teknik i radiologjisë;

5.7. Infermiere i/e diplomuar;

5.8. Mami e diplomuar.

5.10. Profesionistët shëndetësorë të tjerë me kualifikim të mesëm dhe të lartë, të përcaktuar në regjistrin zyrtar të Ministrisë;

5.11. Bashkëpunëtorët profesional me shkollim jashtë lëmisë së mjekësisë, të evidentuar në regjistrin zyrtar me vendim të Ministrit të Shëndetësisë, në bazë të propozimit të Odës përkatëse të profesionistëve nga neni 78 i Ligjit për Shëndetësi.

6. Në kujdesin parësor shëndetësor, nuk lejohet të behet pranimi i specialistëve nga lëmit e tjera. Specialistët ekzistues nga lëmitë tjera, që tani gjenden në KPSH, do të vazhdojnë punën në këto institucione si konsulent të Mjekëve Familjar, deri në pensionim.

Neni 7 Shërbimet

1. QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, kryen këto shërbime të kujdesit parësor shëndetësor:

1.1. shërbimet e promovimit shëndetësor, përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin;

1.2. shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese;

1.3. shërbimet esenciale kurative dhe ndërhyrje të vogla kirurgjike;

1.4. shërbime të kujdesit akut dhe urgjent;

1.5. shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet kronike;

- 1.6. shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë, adoleshentë dhe të rinjtë;
- 1.7. shërbimet e planifikimit familjar;
- 1.8. shërbimet e kujdesit ante/peri dhe post natal;
- 1.9. shërbimet e shëndetit oral prevenues;
- 1.10. shërbimet e shëndetit mendor;
- 1.11. shërbimet e kujdesit shtëpiak përfshirë shërbimet e kujdesit neonatal dhe atij terminal/palativ;
- 1.12. shpërndarjen e barërave nga lista esenciale.

Neni 8 Përfaqësimi

1. QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” në Gjilan, është institucion i cili bën pjesë në rrjetin e institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor, publik të Ministrisë së Shëndetësisë.
2. QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, kryen dhe ofron shërbime të kujdesit parësor për qytetarët e komunës, sipas dispozitave ligjore që janë në fuqi.
3. Për nënshkrimin e kontratave, më të cilat fitohen, tjetërsohen apo shiten objektet dhe pajisjet kapitale, me ose pa vlerë regjeneruese të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, duhet të ketë së pari propozimin e menaxhmentit të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” dhe aprovimin e themeluesit në bazë të ligjeve në fuqi.
4. Drejtori i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, ka të gjitha autorizimet për përfaqësimin juridik dhe afarist, brenda veprimtarisë së QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” me pëlqim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

IV. Struktura e Institucionit dhe Sistemi i Informimit në QKMF

Neni 9 Organizimi i QKMF

1. QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, me qëllim të ofrimit të përkujdesit shëndetësor për banorët e vet, organizohet me këto njësi përbërëse:
 - 1.1. Departamenti i Mjekësisë Familjare me këtë përbërje:
 - 1.1.1. Sektori i Mjekësisë Familjare,
 - 1.1.2. Njësia e SISH,
 - 1.1.3. Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit,

1.1.4 Sektori i Shëndetit Oral Preventiv,

1.1.5 Sektori i Kujdesit Urgjent,

1.1.6 Sektori i Diagnostikës,

1.1.6.1. Kabineti Radiologjik,

1.1.6.1. Laboratori,

2. Departamenti i Administratës së QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” Gjilan organizohet në:

2.1. Njësia ose Zyra juridike dhe e personelit

2.2. Njësia ose Zyra për buxhet dhe financa,

2.3. Njësia ose Zyra për shërbime teknike

3. Barnatorja Qendrore;

3.1. Barnatorja është njësi organizative e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, e cila themelohet dhe funksionon sipas ligjeve dhe akteve nën ligjore, që rregullojnë veprimtarinë farmaceutike;

3.2. Në barnatore pranë QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, mund të shpërndahen vetëm barnat nga lista esenciale e barnave, e lejuar nga Ministria dhe të përshkruara në recetat unike nga mjekët familjarë.

3.3. Çdo tregtim me barna komerciale në barnatoret brenda QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, është i ndaluar dhe sanksionohet sipas ligjeve në fuqi.

3.4. Me barnatoren udhëheqë magjistri i farmacisë.

4. Për të përmbushur obligimet që dalin nga Ligji për Shëndetësi në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” në Gjilan, funksionon edhe Qendra e Trajnimit të Mjekësisë Familjare – QTMF, Njësi e Qendrës së Zhvillimit të Mjekësisë Familjare e Kosovës-QZHMFK, ku mbahet trajnimi i mjekëve dhe infermierëve, në programet e Mjekësisë Familjare.

5. Lista e qendrave të Mjekësisë Familjare –QMF dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare - AMF në kuadër të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” në Gjilan, përbëjnë rrjetin e institucioneve të KPSH në Komunën e Gjilanit.

6. Rrjeti i institucioneve shëndetësore sipas paragrafit 5, do të jetë objekt i revidimit periodik që do të ndërmerret nga KK i Gjilanit, me pëlqim të Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 10
Sistemi i informimit shëndetësor në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”

1. QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” në Gjilan, zbaton sistemin unik të informimit shëndetësor, ashtu siç është paraparë me Ligjin e Shëndetësisë dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë lëmi.
2. Për qëllime të sistemit të informimit shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-DSHMS dhe QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, do të zhvillojnë një sistem unik të kodeve për të gjitha QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” dhe departamentet e saj.
3. QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” bënë mbledhjen, evidentimin, vendosjen e të dhënave statistikore në njësinë e SISH, në programin kompjuterik të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili përmban të dhënat e nevojshme për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore.
4. Çdo profesionist shëndetësor, gjatë raportimit duhet të sigurojë fshehtësinë profesionale duke mos cenuar të drejtat e pacientit, përveç rasteve të rregulluara me ligj.
5. Sistemi i informimit shëndetësor në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” e përbëjnë:
 - 5.1. Sistemi i evidencave me të cilin rregullohet evidentimi i të dhënave;
 - 5.2. Sistemi me të cilin rregullohet dërgimi, gjegjësisht grumbullimi i të dhënave, përpunimi i tyre dhe publikimi i tyre.

V. Udhëheqja dhe trupat e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”

Neni 11
Këshilli Drejtues, struktura

1. Këshilli Drejtues ka 5 anëtarë:
 - 1.1. Drejtori i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, i cili e kryeson Këshillin;
 - 1.2. Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare;
 - 1.3. Kryeinfermieri/ja i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”;
 - 1.4. Udhëheqësi i Departamentit të Administratës;
 - 1.5. Koordinator i për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.
2. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjatë sa edhe kontrata e punës së tyre, por mund të përfundojë edhe më parë në rastet kur:
 - 2.1. anëtari ndërprente marrëdhënien e punës në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”,
 - 2.2. anëtari i Këshillit Drejtues jep dorëheqje;

2.3. anëtari i Këshillit Drejtues mungon pa arsye në mbledhje të Këshillit, brenda vitit tri herë radhazi,

2.4. anëtari nuk i respekton detyrat e punës.

Neni 12

Kompetencat dhe detyrat e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues kryen detyrat e përcaktuara me këtë Statut dhe vendos për:

- 1.1. veprimtarinë e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” dhe vërteton politikën punuese të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”;
- 1.2. propozon ndryshimet e Statutit të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, të cilat i aprovon Ministria e Shëndetësisë;
- 1.3. aprovon raportin e punës dhe llogaritë vjetore të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” dhe raportin në Divizionin e Kujdesit Parësor në Ministrinë e Shëndetësisë, përmes Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
- 1.4. vendos për shfrytëzimin e mjeteve në kuadër të ligjit;
- 1.5. përgatitë programin e punës dhe planin financiar;
- 1.6. nxjerr rregulloren për organizimin e punës në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” dhe aktet tjera në përputhje me politikën e MSH, ligjin dhe me këtë Statut;
- 1.7. harton planin e burimeve njerëzore sipas propozimit të Këshillit Profesional brenda resurseve të disponueshme dhe në përputhje me politikën e MSH;
- 1.8. harton planin e furnizimit të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, dhe vendos për dhënien në shfrytëzim të lokaleve dhe mjeteve, furnizimin dhe dhënien në shfrytëzim të mjeteve të veçanta pas marrjes së pëlqimit nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Ministrinë e Shëndetësisë.
- 1.9. harton planin mbi ZHVP në përputhje me Planin Nacional të ZHVP të kuadrit mjekësor dhe siguron aplikimin e tij;
- 1.10. bënë planin dhe programin e masave për mbrojtje në punë;
- 1.11. vendos për mbarëvajtjen e punëve;
- 1.12. emëron komisione të përkohshme dhe organe tjera punuese;
- 1.13. vendos për sigurimin e pasurisë së QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, sigurimin e punëtorëve në bazë të ligjit;
- 1.14. propozon ndërtimin dhe adaptimin e objekteve, si dhe për burimet e mjeteve për kryerjen e këtyre punimeve duke u bazuar në politikën shëndetësore të MSH;

- 1.15. shqyrton njoftimet mbi mbikëqyrjen e raporteve të përkohshme mbi punën profesionale.
- 1.16. kryen edhe punë të tjera të cilat i janë lënë në kompetence, me këtë statut dhe aktet tjera normative të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”;
2. Këshilli Drejtues i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” i kryen detyrat brenda përgjegjësisë të veta në takime;
3. Këshilli Drejtues mbanë takime të rregullta në të cilat marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve;
4. Këshilli Drejtues merr vendime me shumicë të votave të anëtarëve të zgjedhur;
5. Në takimet e Këshillit Drejtues mbahet procesverbali, të cilin e aprovojnë pjesëmarrësit në takimin vijues.

Neni 13

Drejtori i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”

1. QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” e udhëheqë drejtori;
2. Drejtori përfaqëson, prezanton QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” dhe është përgjegjës për menaxhimin dhe ligjshmërinë e punës.
3. Drejtori i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, përgjigjet për menaxhimin mjekësor, administrativ dhe financiar të të gjitha funksioneve të shërbimeve në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, dhe Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Neni 14

Procedura për emërimin dhe shkarkimin e drejtorit

1. Drejtori i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” zgjidhet në përputhje me Ligjin për Shërbimin Civilë të Republikës së Kosovës Nr.03/L-149 me konkurs publik të shpallur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale .
2. Drejtorin e zgjedh Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale -DSHMS.
3. Drejtor i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” duhet të zgjidhet personi, i cili i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të punësimit, në bazë të ligjeve në fuqi:
- 3.1. të jetë mjek specialist nga Mjekësia Familjare;
- 3.2. përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë përvojë të dëshmuar në procesin e implementimit të mjekësisë familjare ose kandidatët me shkollim profesional në fushën e menaxhimit shëndetësor;

3.3. kandidati për drejtor, duhet t'i ketë 5 vite përvojë pune në sistemin shëndetësor publik, prej tyre 3 vite përvojë pune në pozita menaxheriale.

4. Vendimin për publikimin e konkursit për drejtor të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” e merr DSHMS.

Neni 15

Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”

1. Drejtori i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punë dhe afarizmin e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” si dhe për punën profesionale të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” e cila duhet të organizohet dhe udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij Statuti, dhe akteve tjera normative.

2. Drejtori i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” është përgjegjës për përkujdesjen efikase dhe efektive të kujdesit parësor shëndetësor, për të gjithë banorët e Komunës së Gjilanit dhe përgjigjet për detyrat që vijojnë:

- 2.1. në pajtim me Politikën Shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi Nr. 04/L-125 dhe Strategjinë e Kujdesit Parësor Shëndetësor, drejtori i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” i propozon për miratim DShMS, Planin e Punës dhe Buxhetin e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” për vitin vijues;
- 2.2. drejtori është përgjegjës për implementimin e Planit të burimeve njerëzore;
- 2.3. nën mbikëqyrjen dhe autorizimin e DShMS, e zbaton buxhetin e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”;
- 2.4. është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”;
- 2.5. avancoi punën ekipore;
- 2.6. mundëson zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”.
- 2.7. menaxhon implementimin e standardeve të cilësisë;
- 2.8. kontribuon në zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor të QKMF;
- 2.9. identifikon partnerët dhe zhvillon marrëdhënie me donatorët, Organizatat Jo-Qeveritare;

3. Programi i punës së QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, realizohet duke u bazuar në politikat zhvillimore të sistemit shëndetësor të hartuara nga MSH.

4. Në programin vjetor të punës duhet të përcaktohen objektivat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” si:

- 4.1. plani vjetor i punës;
- 4.2. organizimi dhe udhëheqja;
- 4.3. burimet njerëzore;
- 4.4. plani financiar;
- 4.5. raportet e punës mujore, vjetore dhe raportet financiare;

5. Për kryerjen e punëve të tij, drejtori i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” i përgjigjet Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Neni 16

1. Drejtori ka për detyrë që gjatë punës dhe vendimeve që i merr Këshilli Drejtues, të tërheqë vëmendjen:
 - 1.1. Nëse aktet e propozuara janë në kundërshtim me ligjet relevante, përkatësisht në kundërshtim me aktet e përgjithshme të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”;
 - 1.2. Nëse akti i propozuar është në kundërshtim me programin e punës së QKM “Dr. Nagip Rexhepi”;
 - 1.3. Nëse akti i propozuar nuk i kontribuon qëllimit.

Neni 17

Trupat e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”

1. Për përmbushjen e detyrave të veçanta, Këshilli Drejtues përmes drejtorit të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, formon Trupa Profesionale në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, siç janë:
 - 1.1. Këshilli Profesional;
 - 1.2. Komisioni Disiplinor i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”;
 - 1.3. Komisioni i Ankesave i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”;
 - 1.4. Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore
 - 1.5. Komisioni Etiko – Profesional.
2. Anëtarët e trupave profesionale emërohen nga Drejtori i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”;
3. Këshilli Drejtues, përmes drejtorit të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, sipas nevojës mund të formojë edhe trupa të tjerë profesional në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”.

Neni 18

Këshilli Profesional

1. Këshilli Profesional është trup këshillëdhënës i drejtorit të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”;
2. Këshilli Profesional përbëhet nga udhëheqësit e departamenteve, udhëheqësit e sektorëve dhe njësive, magjistrat të farmacisë si dhe kryeinfermieri/ja e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, sipas nenit 9 të këtij Statuti;
3. Kryetar i Këshillit Profesional, sipas detyrës zyrtare, është Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”;
4. Këshilli Profesional harton Rregulloren e punës për punën e Këshillit.
5. Kryetari i Këshillit Profesional i kryen këto punë:
 - 5.1. përgatit, thërret dhe i udhëheq takimet e Këshillit Profesional;
 - 5.2. verifikon rendin e ditës së takimeve dhe
 - 5.3. siguron mbajtjen e procesverbalit të takimeve.
6. Kryetari i Këshillit Profesional, është i obliguar ta thërras mbledhjen brenda 3 (tri) ditëve, nga dita kur këtë e kërkon drejtori i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”.
7. Këshilli Profesional i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, përveç detyrave të parapara me ligj, i kryen edhe këto detyra:

- 7.1. shqyrton dhe vendos për nevojën dhe arsyet profesionale të implementimit të metodave dhe procedurave të reja diagnostifikuese dhe terapeutike;
- 7.2. propozon Këshillit Drejtues dhe drejtorit marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë;
- 7.3. propozon strukturën e mbikëqyrjes së brendshme, lidhur me punën e punëtorëve shëndetësor si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale;
- 7.4. shqyrton nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe i propozon drejtorit dërgimin e punëtorëve shëndetësor në përsosje profesionale dhe
- 7.5. shqyrton dhe vendos për çështje tjera, të cilat drejtori ia parashtron Këshillit Profesional.

Neni 19

Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore

1. Në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” funksionon Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore;
2. Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore përbëhet nga pesë (5) anëtarë të emëruar nga Këshilli Drejtues;
3. Komitetin për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore e udhëheq profesionisti shëndetësor i caktuar nga drejtori i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”;
4. Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore, është trupë i cili mbikëqyr cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” përmes:
5. Koordinator i cilësisë është profesionisti shëndetësor i/e trajnuar në standardet e cilësisë, i/e cili rekrutohet sipas legjislacionit në fuqi dhe kryen:
 - 5.1. mbikëqyrjen e punës profesionale, mjekësore të ekipeve të Mjekësisë Familjare;
 - 5.2. hulumtime dhe audite klinike ;
 - 5.3. organizimin e rishqyrtimeve kolegjiale;
 - 5.4. propozimin e masave për përmirësim të gjendjes;

Neni 20

Komisioni Etiko-Profesional

1. Komisioni Etiko –Profesional, është trupë i cili siguron kryerjen e veprimtarisë së QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, mbi bazat e etikës dhe profesionalizmit shëndetësor.
2. Përbërja dhe kompetenca e Komisionit Etik-Profesional, rregullohet me Udhëzimin Administrativ për mbikëqyrjen etike -profesionale.

Neni 21

Detyrat dhe përgjegjësitë e trupave tjerë përcaktohen me aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli Drejtues, përmes drejtorit të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, nëse ato nuk janë të përcaktuara me akte të tjera nga MSH.

Neni 22

Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

1. Në kuadër të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” organizohet Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional i të gjithë punëtorëve shëndetësorë, bazuar në dispozitat e Ligjit për Shëndetësi dhe të akteve tjera ligjore, nënligjore që rregullojnë këtë lëmi.
2. Aktivitetet e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP), të Shkollimit Specialistik Pasdiplomik dhe atij të Edukimit Themelor Profesional (ETHP), për profesionistët shëndetësor në KPSH, organizohet në Qendrën e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare të Kosovës (QZhMFK) në ShSKUK-Qendrat Klinike Universitare të Kosovës, në Qendrat për Edukim të Vazhdueshëm Infermierik (QEVI), në Qendrat e Trajnimit të Mjekësisë Familjare (QTMF) të menaxhuar nga QZhMFK, në bashkëpunim me Asociacionin e Mjekëve Familjarë të Kosovë dhe Asociacionin e Infermierisë të Kosovës.
3. Për zhvillimin e aktiviteteve nga paragrafi 2 i këtij neni, përgjegjës janë Koordinatorët dhe trajnuesit në Programet e Mjekësisë Familjare dhe të Infermierisë Familjare, të cilët duhet të kenë përgatitje adekuate akademike dhe profesionale, që caktohen nga Qendra e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare e Kosovës dhe Qendra për Edukim të Vazhdueshëm Infermierik pranë Ministrisë së Shëndetësisë, në bashkëpunim me QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”;
4. Financimi i ZHVP të profesionistët shëndetësor bëhet nga buxheti i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” dhe burime të tjera bazuar në aktet normative në fuqi.

VI. Mbikëqyrja e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”

Neni 23

Llojet e mbikëqyrjes në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”

1. QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, i nënshtrohet mbikëqyrjes së brendshme dhe të jashtme në pajtim me nenin 46 të Ligjit për Shëndetësi që sigurohet përmes DShMS dhe autoriteteve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë;
2. Mbikëqyrja e brendshme e punës profesionale kryhet në mënyrën e paraparë me rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme, të cilën e sjell Këshilli Drejtues i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”;
3. Mbikëqyrja e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” përfshin:
 - 3.1. mbikëqyrjen dhe inspektimin e objekteve të KPSH për infrastrukturën dhe menaxhimin e objekteve;

- 3.2. mbikëqyrjen dhe inspektimin e ofrimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore, sipas normave dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria;
- 3.3. mbikëqyrjen dhe monitorimin e raporteve dhe procedurave financiare, për menaxhimin e fondit të alokuar, të paraparë nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave në përputhje me rregullat e Prokurimit Publik;

VII. Aktet nga veprimtaria e Institucionit

Neni 24 Aktet e përgjithshme

1. Me propozim të drejtorit, Këshilli Drejtues i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” nxjerr këto akte të përgjithshme:
 - 1.1. Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në përputhje me politikat e MSh dhe aktet normative në fuqi ;
 - 1.2. Rregulloren për punë;
 - 1.3. Rregulloren për mbrojtjen në punë;
 - 1.4. Rregulloren për mbrojtjen kundër zjarrit;
 - 1.5. Rregulloren për kontabilitetin e brendshëm;
 - 1.6. Rregulloren për rendin shtëpiak;
 - 1.7. Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme,
 - 1.8. Rregulloren për parandalimin e infeksioneve dhe
 - 1.9. Rregullore të tjera për mbarëvajtjen e punës në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”.

VIII. Pronësia, Buxheti dhe Financat

Neni 25 Pronësia

1. QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” ka në shfrytëzim mjetet dhe pasurinë, e cila është pronë e Kuvendit Komunal.
2. QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” si institucion i KPSH, është përvetësuese e fondit për financim nga Buxheti i Kosovës.
3. Pasurinë e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” e përbëjnë asetet, të drejtat dhe të mirat materiale, me të cilat QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” ka të drejtë t’i disponoj në pajtim me aktet normative në fuqi.

Neni 26 Buxheti

1. Çështjet buxhetore dhe financiare të QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” administrohen në mënyrë transparente, në pajtim me rregulloret për përdorimin e fondeve nga Buxheti i Kosovës, si dhe me të gjitha procedurat, në përputhje me udhëzuesit e Ministrisë së Financave.

2. Buxheti dhe llogaritë e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, përfshijnë tërë shpenzimet operative të njësive punuese.
3. Prokurimi i QKMF “Dr. Nagip Rexhepi” bëhet në pajtim me rregullat e Prokurimit Publik sipas Ligjit në fuqi dhe akteve nën-ligjore.
4. Drejtori mund të kërkoj auditim të jashtëm dhe të monitoroj shfrytëzimin e drejtë të mjeteve.

Neni 27

Financimi

1. QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, shfrytëzon burimet financiare në harmoni me Ligjin për Shëndetësi të Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, nga Buxheti i Kosovës, Buxheti i Komunave dhe nga burimet e tjera, të parapara me ligjet përkatëse.
2. Procedura dhe forma e bashkë pagesës për shërbimet e ofruara në QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, përcaktohet me akt nënligjor bazuar në Ligjin për Shëndetësi.

Neni 28

Shtojca

Aneksi 1 është pjesë përbërëse e këtij Statuti.

IX. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 29

Perioda kalimtare dhe shfuqizimi

1. Në rast se dispozitat e këtij statuti, bien ndesh me dispozitat ligjore, epërsi kanë dispozitat e ligjit.
2. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë të këtij Statuti mbeten aktet që janë në fuqi dhe që nuk janë në kundërshtim me Ligjin për Shëndetësi dhe këtë Statut.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet Statuti i QKMF në Gjilan, 01.nr.4820 dt. 29.04.2009.

Neni 30

Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës.

01.Nr. 016-105965
Gjilan, më 30.10.2015

Kryesuesja e Kuvendit

Valentina Bunjaku Rexhepi

Aneksi 1



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

GLAVNI CENTAR PORODIČNE MEDICINE • MAIN FAMILY HEALTH CENTRE

• •

Mbishkrimi i QKMF



QENDRA E MJEKËSISË FAMILJARE

CENTAR PORODIČNE MEDICINE • FAMILY HEALTH CENTRE

• •

3

Mbishkrimi i QMF (1, 2, 3, ...)



AMBULANTA E MJEKËSISË FAMILJARE

AMBULANTA PORODIČNE MEDICINE • RURAL FAMILY HEALTH CENTRE

• •

Mbishkrimi i AMF



Vula e Rrumbullakët e QKMF



Vula e Rrumbullakët e QMF



Vula e Rrumbullakët e AMF

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO		
Komuna e	• Opština	• Municipality of
No.:		QKMF • GCPM • MFHC
Datë/Datum/Date: _____/_____/_____		
Vendi/Mesto/Place: _____		
Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____		

Vula e Katrore e QKMF

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO		
Komuna e	• Opština	• Municipality of
No.:		QMF • CPM • FHC
Datë/Datum/Date: _____/_____/_____		
Vendi/Mesto/Place: _____		
Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____		

Vula e Katrore e QMF

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO		
Komuna e	• Opština	• Municipality of
No.:		AMF • APM • RFHC
Datë/Datum/Date: _____/_____/_____		
Vendi/Mesto/Place: _____		
Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____		

Vula e Katrore e AMF